

---

**AKT THEMELI DHE STATUTI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"OLYMPIA ITALIA" SHPK**

---



*Arbën Mer*

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"OLYMPIA ITALIA" SHPK**

Sot më datë 08.09.2021 u paraqit personalisht:

**Alfred Meçe**, atësia Shërbim, amësia Iblo, shtetas Shqiptar, lindur në Vergo, Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë Lagja Nr 1; Sarandë; 0000; Sarandë, lindur më 24/03/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 027469070 dhe nr. personal H00324097C

Ne baze të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe në ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Q.K.B, kërkoi redaktimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë është "OLYMPIA ITALIA" Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2**


**SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë në: Lagja Nr.2, Sheshi 7, Sarandë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA**


- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar



## NENI 4

### OBJEKTI I SHOQERISE

4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuar ne:

- 
- Prodhimin e çantave dhe artikujve të tjerë të lëkurës, veshjeve, paketimeve te ndryshme të artikujve të lëkurës dhe te tekstitil, këpucë, këmisha, lavanderi.
  - Tregtimin me shumicë dhe pakicë të artikujve të pakeluar të veshjeve të çdo lloji duke përfshire trikotazh dhe këmisha, aksesore te veshjeve, të brendshme, këpucë.
  - Artikuj sportivë, produkte tekstili përfshire ato për arredimin e ambienteve te brendshme, importin-eksportin e tyre.
  - Shoqëria mund të kryejë të gjitha ato aktivitete që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë të specifikuar më lart, duke përfshire të gjitha transaksionet e një natyre të luajtshme, të patundshme, financiare dhe bankare, të dobishme ose të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë dhe mund të marrin pjesë në Shoqëri ose njësi të tjera që kanë qëllime të ngjashme ose të ngjashme me qëllimet e tyre , të gjitha brenda kufijve të lejuar me legjislacion në fuqi.

4.2 Për te realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shoqëria mund te veproje ne Shqipëri dhe jashtë, dhe te kryejë çdo aktivitet tjetër te nevojshëm, te lidhur, instrumental, te përafërt, elementar, ose sidoqoftë te dobishëm, për shembull:

## NENI5

### KAPITALI I SHOQERISE

5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabarte me 100.000 Leke (njqindmije Leke), i shlyer plotësisht, me para, nga ortakut **Alfred MEÇE**.

5.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet nga 1 kuota, te ndara si me poshte vijon:

- ***1 kuote qe perben 100% te kapitalit, me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, e shlyer nga ortakut Alfred MEÇE.***



- 5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaket themelues.
- 5.4 Asnjë nga ortaket nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakeve të tjerë. Në rast se një nga ortaket dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakeve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortaket do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.
- 5.5 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortaket do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimi të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

#### NENI 6

#### **KALIMI I KUOTES ME TRASHËGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PËR SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT**

- 6.1 Në rast vdekje apo falimentimi të njërit prej ortakeve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtareve apo personave që fitojnë këto të drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut. Në rast refuzimi të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtareve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.
- 6.2 Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si

*Albin Mer*

përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuote për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si zotërues i kuotes.

## NENI 7


### ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejte me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejte me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## NENI 8

### ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.



5  
*Alfred*

- 8.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## NENI 9

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë me shkrim .

- 9.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortaket në bazë të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar

6  
*[Signature]*

për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakeve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

9.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon nën 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nënit 86 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqëritë tregëtare".

9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të të paktën 51 % të ortakeve pjesëmarrës ( shumica e kualifikuar) në bazë të nënit 87 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqëritë tregëtare", për ndryshimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.


#### NENI10

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

7  
Alba Mu

10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhe prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator:

- ***Alfred Meçe, atësia Shërbim, amësia Iblo, shtetas Shqiptar, lindur në Vergo, Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë Lagja Nr 1; Sarandë; 0000; Sarandë, lindur më 24/03/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 027469070 dhe nr. personal H00324097C***



10.2 Administratori/t zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.

10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërbëlimin e administratoreve të shoqërisë.

10.4 Administratorët nuk do të mund të marrin hua nga Shoqëria ose të lëshojnë garanci, dorëzani, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financime të dhëna nga të tretët.

10.5 Administratorët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

## NENI 11

### VITI FINANCIAR

 8  




11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

## NENI 12 KONTROLI FINANCIAR

12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet ne baze te ligjit.

## NENI 13 BILANCI VJETOR

13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .

13.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## NENI 14 DIVIDENDET

14.1 Ne përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

## NENI 15 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

15.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtrohen juridiksionit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

  
9

**NENI 16**

**GJUHA**

16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

**NENI17**

**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

17.1 Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne këtë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

**ORTAKI SHOQERISE**

Shoqeria "OLYMPIA ITALIA" SHPK

ALFRED MEÇE

ALFRED MEÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER GJERGJ R. KONGOLI



DATE 08/09/2021

NR REP 4239

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 08.09.2021 ara meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINSTRATIVE NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA NR. 3 , u paraqit personalisht:

**DEKLARUESI:** Alfred Meçe, atësia Shërbim, amësia Iblo, shtetas Shqiptar, lindur në Vergo, Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë Lagja Nr 1; Sarandë; 0000; Sarandë, lindur më 24/03/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027469070 dhe nr. personal H00324097C , me vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise "OLYMPIA ITALIA" SHPK

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

GJERGJ R. KONGOLI

